

Sektori financiar në regjion ka luajtur dhe është duke luajtur një rol të rëndësishëm në rritjen ekonomike. Konsumi vazhdon të jetë nxitësi kryesor i aktivitetit ekonomik në vendet e Ballkanit Perëndimor, i stimuluar nga shpenzimet më të larta publike dhe përafërsisht rritje dyshifrore në kreditimin e ekonomive familjare.

Bankat dhe institucionet tjera kreditore ka qenë gjithnjë shumë të rëndësishme për rritjen ekonomike në regjionin tonë, pasi që iu mundësojnë qasje në financa sektorit privat por edhe qeverive gjithashtu. Unë mendoj se është e qartë se një sektor stabil financiar kontribuon në rritjen ekonomike dhe ky rol mbetet i rëndësishëm.

Në rastin e Kosovës, një sektor financiar i sigurtë dhe i shëndoshë është parakusht për rritje ekonomike të qëndrueshme. Një sektor financiar solid dhe që funksionon mirë është një motor i fuqishëm prapa rritjes ekonomike. Ky sektor gjeneron kursime brenda vendit, të cilat më pas mundësojnë investimet në bizneset e vendit.

Performanca e mirë e sektorit financiar nënkupton më shumë kapital në dispozicion për investime dhe sa më shumë eficient që sektori financiar të bëhet, aq më shumë ka gjasa, që resurset ekonomike të Kosovës të drejtohen drejt përdorimit më produktiv dhe më këtë rritja ekonomike të arrij potencialin e saj të plotë.

Fakti që ne kemi rritje dyshifrore në kreditim në vitet e fundit është një tregues se sektori financiar është duke luajtur rolin e pritur nga ai në financimin e rritjes ekonomike dhe ka edhe më shumë potencial për këtë aspekt. Për më tepër, bankat në mënyrë efektive kanë kanalizuar remitencat private dhe si rrjedhojë sektori financiar siguron bazën për rritje ekonomike dhe të punësimit.

Rritja ekonomike në anën tjetër krijon kushte më të favorshme për zhvillimin e sektorit financiar dhe do të rrisë mundësitë e sektorit financiar, të cilat nëse shfrytëzohen do të shpien në një cikël të kontribuimit edhe më të lartë në zhvillimin ekonomik.

Rritja ekonomike do të tërheq edhe më shumë kapital dhe investime në sektorin financiar, të cilat do të sigurojnë bazë më të gjërë për zhvillimin dhe rritjen e mëtutjeshme të tij. Rritja ekonomike do të mundësoj zhvillimin e instrumenteve dhe tregjeve financiare pasi që do të kërkoj gjithashtu nga ndërmjetësit financiar që të bashkëpunojnë më shumë dhe kjo do të rezultojë me zvogëlim të kostove dhe rritje të eficiencës.

Roli kyç i bankave qendrore është drejtimi i politikës monetare për të arritur stabilitet të çmimeve (inflacion të ulët dhe stabil) dhe të ndihmoj në menaxhimin e luhatjeve ekonomike. Kosova ka adoptuar euron si valutë të saj dhe është e kufizuar sa i përket instrumenteve të politikës monetare.

Për shkak të mjeteve të kufizuara të politikës monetare Banka Qendrore e Republikës së Kosovës do të rrisë marrëdhënien e rritjes dhe financimit duke siguruar stabilitet financiar dhe rritjen e mbikëqyrjes makroprudenciale duke e orientuar kornizën rregullative drejt një perspektive makroprudenciale.

Deri më tani rregullativa mikroprudenciale kishte për qëllim të rrisë sigurinë dhe shëndetin e institucioneve financiare individuale. Pikëpamja makroprudenciale do të fokusohet në mirëqenien e sistemit financiar në tërësi gjë që siç edhe e thashë edhe më herët është një parakusht për rritjen ekonomike.

Rreziku sistemik siç e dimë të gjithë mund të ketë efekte shumë të dëmshme nëse materializohet. Rritja ekonomike dhe mirëqenia e qytetarëve do të afektohen në masë të madhe nga rënia e produkteve dhe shërbimeve financiare të sistemit financiar.

Këto efekte janë parë në krizën financiare e cila filloi në vitin 2007. Recesionet ekonomike kanë afektuar disa vende në ekonomitë e zhvilluara.

Politikat makroprudenciale duhet të zhvillohen për të promovuar stabilitetin financiar. Nëse ne kemi një sistem stabil dhe të shëndoshë financiar do të jemi në gjendje më të mirë për t'u ballafaquar me goditjet e krizave ekonomike dhe të evitojmë pasojat më të mëdha të krizës financiare.

Për të promovuar stabilitetin financiar në Kosovë, politika makroprudenciale do të fokusohet në forcimin e sistemit bankar në atë mënyrë që të mund të përballoj lëvizjet negative në çmimet e kredive dhe të pronave dhe të goditjeve tjera makroekonomike. Politikat makroprudenciale duhet të jenë me vështrim përpara me qëllim të zvogëlimit të rrezikut sistematik pasi që mund të shpie në një shqetësim financiar.

BQK-ja ka zgjedhur të ndjek praktikën e Bordit Evropian të Rrezikut Sistemik (ESRB) të zërthimit të këtij objekti të nivelit të lartë në një set të objektivave të ndërmjetme dhe më të prekshme.

Brenda kornizës së ESRB, secila nga këto objektiva të ndërmjetme është e harmonizuar me një set të indikatorëve të rrezikut dhe instrumenteve të politikave të cilat kanë potencial mitigues me qëllim të parandalimit të rritjes së tepërt të kreditimit dhe leverazhit, duke kufizuar koncentrimin e ekspozimeve kreditore në mënyrë direkte dhe indirekte dhe zvogëlimin e mundësisë që bankat më rëndësi sistemike të adoptojnë dhe ndjekin strategji të papërshtatshme.

Politika makroprudenciale do të adresoj rreziqet të cilat nuk janë të mbuluara nga mbikëqyrja mikroprudenciale apo me pjesët tjera të politikave. Nëse kemi banka individuale të shëndosha financiarisht kjo nuk e bën sektorin financiar të shëndoshë gjithashtu, pasi që veprimet e përbashkëta të bankave mund të krijojnë mosbalancim brenda ekonomisë dhe ta bëjnë sektorin financiar të ndjeshëm ndaj goditjeve negative ekonomike.

Zhvillimet e fundit, veçanërisht përparimet dhe inovacionet teknologjike dhe paraqitja e kompanive Fintech ka rritur integrimin financiar dhe ndërlidhjen ndërmjet bankave si dhe ekonomisë reale me sektorin financiar. Për më tepër, ka rritur gjithashtu integrimin ndërkufitar dhe është duke e zhvilluar dukshëm fushëveprimin jo vetëm të bankave por edhe tregjeve financiare në përgjithësi.

Këto zhvillime theksojnë dhe rrisin rëndësinë e mbikëqyrjes makroprudenciale dhe të bashkëpunimit ndër-kufitar ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse. Teknologjitë e reja mund të shpien në fushëveprim të ri financiar që mund t'i zhvendos shërbimet financiare në fusha të parregulluara apo më pak të rregulluara.

Kjo është një sfidë e re për stabilitetin financiar dhe kërkon një qasje të re të mbikëqyrjes makroprudenciale për të matur dhe mbikëqyrur rreziqet ekzistuese dhe rreziqet e reja pa marrë parasysh se nga gjenerohen ato në sistemin financiar.

BQK-ja ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt operacionalizimit të kornizës së politikës makroprudenciale. Është në proces të ndryshimit të ligjit për të forcuar bazën e fuqisë ligjore të BQK-së lidhur me politikën makroprudenciale.

Gjatë kryerjes së detyrave të saj të mbikëqyrjes, BQK-ja së bashku me Ministrinë e Financave ka themeluar Komitetin e Stabilitetit Financiar me qëllim të Përgatitjes për Kriza dhe sigurim të Stabilitet Financiar.